

IDFI

Instituti për Zhvillimin e Lirisë së Informimit

Udhëzime për prokurimet publike në lidhje me Kovid-19

Prill 2020

OPEN SOCIETY FOUNDATIONS

TPPR

Publikimi i këtij artikulli është financuar nga Fondacioni i Institutit për Shoqëri të Hapur të Budapestit (OSI). Opinionet e shprehura në këtë dokument i përkasin Institutit për Zhvillimin e Lirisë së Informimit (IDFI) dhe nuk reflektojnë qëndrimin e Fondacionit të Institutit për Shoqërinë e Hapur të Budapestit (OSI). Prandaj, OSI nuk mban përgjegjësi për përmbajtjen e tij.

Qëllimet e këtij udhëzimi

Sot, vendet po hasin sfidën e madhe të kryerjes së prokurimeve të shpejta dhe efikase me qëllim marrjen e mallrave dhe shërbimeve të nevojshme për të luftuar kundër Covid-19. Si rregull, për shkak të gjendjes së emergjencës të shpallur në shumicën e vendeve të prekura nga pandemia, legjislacionet kombëtare parashikojnë nevojën e kryerjes së Prokurimeve Publike brenda afateve të kufizuara të kohës dhe lejojnë shmangien e procesit konkurrues të prokurimit (si p.sh. prokurime elektronike, tendera, etj.). Megjithatë këto dispozita nuk duhet të interpretohen një rrezik ndaj prokurimeve publike transparente dhe të përgjegjshme. Përkundrazi, garantimi i transparencës dhe proceseve të hapura të prokurimit është veçanërisht i rëndësishëm sot, kur një burim i konsiderueshëm financiar (buxheti i shtetit, fondet e posaçme, ndihma ndërkombëtare dhe donacionet private) shpenzohen për të kryer prokurime urgjente që kanë si synim luftën ndaj pandemisë. Ky shqetësim bazohet në shembujt e mëparshëm të praktikave korruptive në procesin e prokurimeve mjekësore, si ato që lidhen me krizën e ebolas¹. Kjo është veçanërisht e rëndësishme për vendet me të ardhura të ulëta, duke qenë se ato janë më të prekura nga rreziqet e korrupsionit².

Për të luftuar në mënyrë efikase ndaj pandemisë, shtetet duhet të mbështeten tek eksperiencat e kaluara dhe të marrin çdo hap të nevojshëm për të garantuar akses të hapur në informacionet që lidhen me prokurimet për Covid-19. Shoqëria në përgjithësi duhet të ketë mundësi ta mbikqyrë procesin dhe të mund të ndjekë shpenzimet për prokurime përmes sistemeve shtetërore relevante të prokurimit publik. Kjo do të rrisë besimin publik tek qeveritë dhe do të mobilizojë përpjekjet e përbashkëta për menaxhimin e krizës së pandemisë.

Këto udhëzime kanë për qëllim t'u ofrojnë vendimmarrësve dhe organizatave të shoqërisë civile informacione lehtësisht të kuptueshme mbi hapat që duhet të merren në procesin e kryerjes së prokurimeve me qëllim marrjen e masave ndaj sfidave që ka shkaktuar pandemia aktuale. Për të garantuar plotësimin e standarteve më të larta të transparencës në prokurimet publike që lidhen me Covid-19 dhe për të garantuar se nuk janë të ekspozuara ndaj rreziqeve të korrupsionit, duhet të merren hapa në këto drejtime:

1. Krijimi i një sistemi të unifikuar të prokurimit publik – Shtetet duhet të marrin masa që prokurimi publik të kryhet përmes një sistemi të unifikuar. Ky sistem duhet të përdoret në të gjitha fazat e prokurimit duke përfshirë fazat para tenderimit, gjatë tenderimit dhe pas tenderimit. Informacionet në faqet zyrtare të internetit duhet të publikohen në kohën e duhur dhe duhet të jenë në dispozicion në formate të lexueshme nga kompjuteri (d.m.th. që të mund të lexohen dhe të përpunohen automatikisht nga kompjuteri). Për të plotësuar standartet për transparencë të plotë, këto sisteme duhet të respektojnë standartet e të dhënave të hapura të kontraktiveve (OCDS), gjë që mundëson zbardhjen e të dhënave dhe dokumenteve në të gjitha fazat e procesit të kontraktimit, duke përcaktuar modele të përbashkëta të të dhënave dhe duke mbështetur formate të ndryshme të dokumenteve dhe të dhënave. Sistemi duhet të përmbajë informacione për prokuruesit, furnitorët, objektin e prokurimit, burimin e financimit (buxheti i shtetit, fond i posaçëm, ndihmë

¹ https://www.transparency.org/neës/feature/corruption_and_the_coronavirus <http://ti-health.org/wp-content/uploads/2019/03/IgnoredPandemic-WEB-v3.pdf>

² <https://www.u4.no/publications/corruption-in-the-time-of-covid-19-a-double-threat-for-loë-incomecountries.pdf>

ndërkombëtare, donacion privat), llojin e prokurimit, kodet e prokurimit sipas kategorive dhe nënkategorive, çmimin dhe vlerën e parave të transferuara;

2. Aksesimi në rregulla dhe udhëzime relevante – rregullat dhe udhëzimet që rregullojnë proceset e Prokurimit Publik, duke përfshirë informacionet për procedurën të kryerjes së prokurimeve që lidhen me Covid-19 duhet të jenë të disponueshme në formate të lexueshme nga kompjuteri;

3. Lista e mallrave, punimeve dhe shërbimeve që mund të blihen duke përdorur prokurimet urgjente në lidhje me Covid 19 – si rregull, juridiksionet kombëtare përfshijnë kriteret e kryerjes së prokurimeve urgjente, megjithatë deri tani, në kohën që është shpallur gjendja e emergjencës nga shumica e vendeve, prokuruesit janë shpesh të përjashtuar nga detyrimi i plotësisht të këtyre kriterëve dhe mund të kryejnë prokurime urgjente pa justifikime relevante. Kjo çon në rrezikun e shpërdorimit të situatës aktuale në kohën kur subjektet publike kryejnë prokurime urgjente për të blerë mallra, punime dhe shërbime që nuk lidhen me pandeminë. Për të shmangur këtë skenar shtetet të miratojnë lista mallrash, punimesh dhe shërbimesh të nevojshme për të luftuar kundër Covid-19. Prokurimi urgjent gjatë pandemisë duhet të përdoret vetëm për blerjen e mallrave, punive dhe shërbimeve që përfshihen në këto lista. Bashkë me shmangien e shpërdorimit të gjendjes së emergjencës nga prokuruesit publikë kjo qasje duhet gjithashtu të garantojë shpenzime më të përgjegjshme të buxhetit, gjë që është bërë edhe më e rëndësishme në këto rrethana kur vendet përballen me krizën ekonomike;

4. Informacione për komunikimet me furnitorët e mundshëm para zhvillimit të tenderave – aksesimi në komunikime mes subjekteve shtetërore dhe furnitorëve para zhvillimit të tenderimeve është veçanërisht i rëndësishëm në rastin e prokurimeve të drejtpërdrejta. Në kushtet e pandemisë, autoritetet kryejnë shpesh prokurime të drejtpërdrejta, duke u nisur nga fakti se për mallra apo shërbime të caktuara ka vetëm një ofrues. Ndonëse këto mund të jenë të nevojshme, kjo lloj procedure përbën rreziqe për njëanshmëri dhe fryrje të qëllimshme të çmimeve, duke çuar kështu në nevojën për mbikqyrje të veçanta nga publiku;

5. Publikimi i plotë i kontratave – tekstet e plota të kontratave të lidhura, shtojcat e tyre dhe çdo ndryshim që bëhet në to, duhet të vendosen në sistemin e unifikuar të Prokurimit Publik në një format të lexueshëm nga kompjuteri;

6. Informacione për procesin e zbatimit të kontratave – është shumë e rëndësishme që procesi i zbatimit të kontratave të jetë plotësisht transparent dhe t'i japë mundësi publikut që të monitorojë nga afër efikasitetin e proceseve të Prokurimit Publik dhe shpenzimeve të buxhetit.

7. Raportet tremujore për prokurimet e kryera, rezultatet e tyre dhe procesin e zbatimit - së bashku me transparencën e plotë të çdo procesi prokurimi, raportet tremujore duhet të publikohen rregullisht nga subjektet prokuruese. Në rastin e prokurimeve që lidhen me Covid-19, këto raporte duhet të publikohen çdo javë;

8. Motorët e kërkimit të furnitorëve të jenë të disponueshëm në formate të dhënash të hapura – motorët e kërkimit duhet të përfshijnë profilet e kompanive dhe informacione për prokurimet ku ato kanë marrë pjesë si dhe të kontratave të zbatuara prej tyre dhe listën e mallrave të shërbimeve që ato do të ishin në gjendje të ofronin. Ky sistem do të ishte veçanërisht i dobishëm për subjektet

publike në procesin e kërkimit të shërbimeve të nevojshme mjekësore, mallrave apo paisjeve që nevojiten për të luftuar Covid-19. Sisteme relevante përdoren shpesh brendapërbrenda prokuruesve, por ato rrallë vendosen në dispozicion të publikut. Publikimi i këtyre bazave të të dhënave do t'i japë mundësi shoqërisë në përgjithësi që të mund të ndjekë informacionet për kompanitë dhe të kryejë një monitorim efikas të prokurimit publik në lidhje me shpenzimet e buxhetit.

9. Publikimi i listës së kodeve të identifikimit të prokurimit për mallrat e listuar më sipër, si dhe një listë kodesh për prokurimet që lidhen me Covid-19 – për të mundësuar ndjekjen me lehtësi të prokurimeve që lidhen me Covid-19, shtetet duhet të publikojnë listat e CPV³, listat e kodeve CPV për mallrat, punimet dhe shërbimet e sipërpërmendura. Në të njëjtën kohë, publiku duhet të jetë në gjendje të bëjë kërkime për kodet e prokurimit që lidhen me Covid-19;

10. Informacione për hapat e marrë me qëllim parandalimin ose reagimin ndaj rasteve të fryrjes së çmimeve – në rrethanat aktuale, kur ka mungesë të paisjeve dhe mallrave mjekësorë të nevojshëm për përballimin e pandemisë, furnitorët janë të prirur të rrisin çmimet. Për të shmangur rritjen e egzagjeruar të çmimeve, shtetet duhet të miratojnë politika relevante kundër kompanive që veprojnë në këtë mënyrë.

11. Dialogu dhe partneriteti me biznesin – shtetet duhet të nxisin sektorin privat që të kontribuojë në procesin e përballimit të pandemisë. Ato duhet ta drejtojnë procesin drejt prodhimit të mallrave dhe paisjeve jetësore për të luftuar kundër Covid-19. Shtetet duhet të ofrojnë subvencione për kompanitë, duke garantuar kështu që biznesi të jetë i interesuar për të marrë pjesë në këtë proces.

12. Diversifikimi i furnitorëve – diversifikimi i furnitorëve do të jetë veçanërisht i rëndësishëm në periudhën pas krizës, kur bizneset e vogla do të kenë nevojë për rikuperim financiar. Duke zgjeruar objektin e subjekteve private që marrin pjesë në biznesin e prokurimit nga shtetet, sidomos bizneset e vogla dhe të mesme, shtetet do të sigurohen që financat publike të shpenzohen në mbështetje të rikuperimit të një game të gjerë operatorësh biznesi.

³ Kodet CPV është një sistem klasifikimi për prokurimin publik që përdor një fjalor të standardizuar për të ndihmuar punonjësit e prokurimeve që t'i klasifikojnë njoftimet e kontratave në mënyrë konsistente dhe për t'ua bërë më të lehtë furnitorëve dhe autoriteteve kontraktuese që të gjejnë njoftimet.